

VENDIM
Nr. 168, datë 4.11.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KODIT TË RRJETIT QË
HARMONIZON STRUKTURAT TARIFORE TË TRANSMETIMIT TË GAZIT**

Në mbështetje të nenit 4, pika 55, nenit 6, nenit 32 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, parashikimeve të vendimit nr. 2018/07/PHGL–EnC, datë 28.11.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, si dhe nenit 26 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 4.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/5 prot., të përgatitur nga drejtoritë teknike mbi fillimin e procedurës për miratimin e Kodit të Rrjetit që Harmonizon Strukturat Tarifore të Transmetimit të Gazit,

konstatoi se:

- Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 18 prot., datë 18.2.2019, ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në ERE, Kodin e Rrjetit që Harmonizon Strukturat Tarifore të Transmetimit të Gazit, të përditësuar dhe të përkthyer në gjuhën shqipe;

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE ka kompetencën të miratojë propozimin për krijimin e Kodit të Rrjetit që Harmonizon Strukturat Tarifore të Transmetimit të Gazit.

- Ky Kod do të shqyrtohet dhe do të miratohet si detyrim i sa më poshtëm:

- Shqipëria është anëtare e Sekretariatit të Energjisë që nga data 1.7.2006;

- parashikimet e rregullores së BE-së nr. 715/2009, të Parlamentit Europian dhe të Këshillit Europës;

- kërkesat e rregullores së komisionit (KE) 2017/460, të datës 16 mars 2017;

- vendimit nr. 2018/07/PHGL–EnC, datë 28.11.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë;

- parashikimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar;

- licencimin shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e Transmetimit të Gazit Natyror;

- licencimin shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e Shpërndarjes së Gazit Natyror;

- certifikimin paraprak të Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror “Albgaz” sh.a., në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 73/2009 EC.

- “Albgaz” sh.a. gëzon statusin e vëzhguesit pranë ENTSO-G, Rrjetit Europian të Operatorëve të Transmetimit të Gazit Natyror.

- Ky akt është draftuar dhe përshtatur në respektim të parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe parashikimeve të vendimit nr. 2018/07/PHGL–EnC, datë 28.11.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, duke dhënë orientim në lidhje me harmonizimin e sistemeve të transmetimit të gazit natyror.

- Në referencë të vendimeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë PHLG- ENC, kjo rregullore do të bëhet e detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Transpozimi do të bëhet pa ndryshime në strukturën e tekstit të rregullores (EU) nr. 2017/460, përveç përkthimit dhe përshtatjes së bëre sipas këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Kodit të Rrjetit që Harmonizon Strukturat Tarifore të Transmetimit të Gazit.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti